



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 291 Akti

Nr. 174 Vendimi  
Tiranë më 1. 7. 2019

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Olsi Komici</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në datën 1 korrik 2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**     **Z. Guxim Zenelaj, anëtar i Gjykatës së Lartë.**

**BAZA LIGJORE:**                     **Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Guxim Zenelaj, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Procesi i rivlerësimit për z. Guxim Zenelaj ka filluar menjëherë me:

- a. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. Plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

3. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ( në vijim Komisioni), në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

4. Trupi gjykues i shortuar për shqyrtimin e çështjes, përbëhet nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Olsi Komici	Anëtar
Firdes Shuli	Relatore

5. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues në datën 26.3.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, komisionere Pamela Qirko. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

6. Konstatohet se, z. Guxim Zenelaj, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tropojë për periudhën 1993 – 1994 . Për periudhën 1994 – 2007 ka kryer detyrën e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për periudhën prill 2007 – janar 2008 ka kryer detyrën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Ai është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë me Dekretin nr. 5794, datë 8.7.2008, të Presidentit të Republikës, miratuar me vendimin nr. 209, datë 28.7.2008, të Kuvendit të Shqipërisë.

7. Subjekti i rivlerësimit, me shkresën e datës 28.7.2017, me lëndë: *“njoftim për dorëzimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë, për shkak të mbarimit të mandatit”*, protokolluar nga Gjykata e Lartë me nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2017, ka njoftuar Gjykatën e Lartë për përfundimin e mandatit të tij 9-vjeçar dhe dorëzimin e detyrës së tij si anëtar i saj.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 3, datë 29.6.2017, vendosi deklarinimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. Guxim Zenelaj, për shkak të përfundimit të mandatit 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës, bazuar në pikën 2, të nenit 139 të Kushtetutës.

9. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2017, Gjykata e Lartë, ka njoftuar Presidentin e Republikës për dorëzimin e detyrës së disa gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për shkak të mbarimit të mandatit, midis të cilëve edhe për gjyqtarin Guxim Zenelaj.

10. Me shkresën e datës 30.4.2018, me lëndë :*“njoftim”*, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2018, dërguar Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ka njoftuar se nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për t’u emëruar gjyqtar apeli dhe se ai ka filluar ushtrimin e veprimtarisë private në profesionin e avokatit, regjistruar në QKB në datën 16.3.2018, duke vlerësuar se statusi i tij si gjyqtar ka mbaruar për shkak të ligjit.

11. Subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2019, dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka konfirmuar se ka hequr dorë nga statusi i magjistratit, sipas nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” që prej datës 16.11.2018.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2019, ka dërguar pranë Komisionit, vendimin nr. 65, datë 24.4.2019, “Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Guxim Zenelaj”, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli.

## **ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

13. Në pikën 5, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është përcaktuar se gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të paragrafi 3 të nenit 139.

14. Pika 1, e nenit 161, dispozitat kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar se gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet magjistrat sipas këtij ligji dhe sipas pikës 2 të po këtij neni: “Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrajnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm....”.

15. Në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur ai jep dorëheqjen.

16. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon: “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

17. Neni “G”, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon : “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

18. Komisioni u njoh me kërkesat e subjektit të rivlerësimit, për dorëheqjen nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli dhe nga statusi i magjistratit, duke dhënë pëlqimin për mosmbajtjen e këtij statusi, si dhe me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për mbarimin e statusit të magjistratit në datën 24.4.2019, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Guxim Zenelaj.

19. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njej Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli dhe nga statusi i magjistratit.

20. Bazuar në sa më sipër, Komisioni, çmon se për subjektin e rivlerësimit, z. Guxim Zenelaj, përmbushen të gjitha kriteret ligjore për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, sipas germës “G” të Aneksit të Kushtetutës. Kjo ndërprerje sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit “G”, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Guxim Zenelaj, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 1.7.2019.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela Qirko**  
**Kryesuese**

**Olsi Komici**  
**Anëtar**

**Firdes Shuli**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*